

Prishtinë 01.06.2015

**BURSAT E MINISTRISË SË SHKENCËS, ARSIMIT DHE SPORTIT TË
REPUBLIKËS SË KROACISË PËR VITIN AKADEMIK 2015-2016**

Ministria e Shkencës, Arsimit dhe Sportit të Republikës së Kroacisë ofron dy (2) bursa për qytetarët e Republikës së Kosovës për studime universitare dhe pasuniversitare. Para regjistrimit për në studime universitare ose pasuniversitare, përfituesve të grantit u kërkohet të vijojnë **një kurs përgatitor njëvjeçar të gjuhës kroate** në Fakultetin Filologjik (CROATIUM). Njohja e mirë / e shkëlqyer e gjuhës angleze është e obligueshme për të aplikuar për bursa.

Bursa e dhënë përfshin:

- Një pagesë mujore prej 1.600 kuna (valutë lokale) për të mbuluar akomodimin në konviktet e studentëve dhe ushqimin në restorantin e studentëve,
- Mbulimi bazë i sigurimit shëndetësor,
- Shpenzimet e kursit përgatitor një vjeçar të gjuhës Kroate.

Studenti është përgjegjës për mbulimin e të gjitha shpenzimeve të udhëtimit për në Kroaci, pasi që bursa nuk e mbulon këtë shpenzim.

Përfituesit e grantit duhet të marrin vizën për të studiuar në Kroaci. Me qëllim të marrjes së vizës me kohë, ju lutem kontaktoni Ambasadën Kroate në Prishtinë.

Kontakti i Ambasadës:

- Ambasada e Republikës së Kroacisë në Republikën e Kosovës
- Fehmi Agani 69/A
- Prishtina
- Kosova
- croemb.prishtina@mvep.hr
- Tel: 00381 38 224 530,
- Fax: 00381 38 223 979.

Për marrjen e lejes së qëndrimit, përfituesi i grantit duhet të paraqesë:

1. Formën e aplikimit,
2. Letrën e pranimi,
3. Dy fotografi me ngjyra (30x35 mm),
4. Kopjen e dokumentit të udhëtimit valide
5. Certifikatën që nuk ka dosje kriminale (jo më të vjetër se 6 muaj).

Gjeni të bashkangjitur formularët e aplikimit në gjuhën angleze që përmbajnë udhëzime rreth skedarëve të nevojshëm.

Aplikacionet për bursë dhe të gjitha dokumentet e nevojshme duhet të dërgohen të mbyllura në zarf në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë deri më 19 qershor 2015, në këtë adresë:

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë,
Rr/Str. Agim Ramadani p.n. 10000 Prishtinë
Arkiva e MASHT , Zyra nr; 4
Aplikacion për bursën e Kroacisë

Të gjitha informatat rreth studimit dhe universitetet në Kroaci, ju mund të gjeni në <http://www.studyincroatia.hr/>

Për të gjitha pyetjet e mëtejshme ju lutem kontaktoni:
znj. Hanëmsha Aliu - Latifi
Zyrtare për bashkëpunim ndërkombëtar
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
email: hanemsha.latifi@rks-gov.net